

Rregullorja për transferimin e kujdesit shëndetësor

Ne duam të sigurohemi që transferimi i pacientëve tanë nga kujdesi shëndetësor pediatrik/për adoleshentë në kujdesin për të rritur të jetë i lehtë. Në këtë proces ne punojmë me pacientët dhe familjet për t'i përgatitur për ndryshimin nga një model kujdesi "pediatrik", ku prindërit dhe kujdestarët marrin shumicën e vendimeve në një model kujdesi për "të rritur", ku pacientët e rritur në moshë të re janë përgjegjës për marrjen e vendimeve. Është e rëndësishme të dini se:

- Teksa pacientët tanë bëhen adoleshentë, një pjesë e vizitave të tyre do të kryhen vetëm për vetëm me ofruesin. Kjo bëhet për t'i ndihmuar të jenë më të pavarur me kujdesin e tyre shëndetësor.
- Kur pacientët bëhen 18 vjeç, ata bëhen të rritur sipas ligjit dhe konsiderohen të aftë për të marrë vendime për kujdesin e tyre shëndetësor. Ne e respektojmë faktin që shumë pacientë vijojnë të lënë familjen e tyre t'i ndihmojë me vendimet për kujdesin shëndetësor. Por informacionin personal shëndetësor do të mund ta diskutojmë me familjarët vetëm me pëlqimin e pacientit.
- Të rinjtë me nevoja kujdesi të veçantë mund të kenë nevojë për më shumë kohë për transferimin në kujdesin për të rritur. Ne mund t'i ndihmojmë pacientët të gjejnë më shumë informacion për kujdestarinë, sipas nevojës.

Ekipi i kujdesit do të ndihmojë adoleshentët dhe familjet të përgatiten për transferim te një ofrues shëndeti për të rritur zakonisht **përpara moshës 22-vjeçare**. Ne do të ndihmojmë në gjetjen e një ofruesi për të rritur dhe do të diskutojmë me ta informacionin shëndetësor të pacientëve tanë dhe nevojave të posaçme.

Mund të na kontaktoni lirisht me pyetjet apo shqetësimet tuaja. Shikoni informacionin e kontaktit më poshtë.

Ekipi juaj i kujdesit:

Numri i kontaktit: